



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË OBILIQIT PËR VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Obiliqit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit (KO), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Obiliqit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Obiliqit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Subvencionimi pa Thirrje publike.
- A2 Pagesat përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore në shumë prej 296,878€.
- A3 Mangësi për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale.
- A4 Tejkalim i kontratës publike kornizë.
- A5 Shkëputja e kontratës pas pranimit të situacionit të parë dhe lidhja e kontratës së re.
- B1 Zotimi i mjeteve jo sipas rregullave financiare.
- B2 Mos zhvillimi i procedurave të rekrutimit përmes SIMBNJ-së.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Obiliqit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Obiliqit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Obiliqit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Obiliqit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Obiliqit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 15 rekomandime, prej tyre nëntë (9) janë rekomandime të reja, pesë (5) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Subvencionimi pa Thirrje publike

Gjetja

Sipas nenit 2.1 të Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatës Jo Qeveritare (OJQ), përcakton që dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga çdo organizatë buxhetore e cila financon projektet dhe programet e OJQ-ve, të cilat janë aplikues apo partner në aplikimet, sipas një thirrje publike për financim të projekteve dhe programeve të OJQ-ve, dhe të cilat i plotësojnë kriteret sipas kësaj Rregulloreje.

Në dy raste janë ekzekutuar pagesa pa pasur shpallje publike. Rasti i parë ishte ekzekutuar në bazë të vendimit të Kryetarit në shumë prej 1,000€ (OJQ), dhe rasti i dytë përmes vendimit të Kuvendit Komunal në shumë prej 30,000€ (Shoqëri aksionare). Bazuar në kriteret dhe procedurat për financimin me subvencione, komuna nuk ka kërkuar vërtetimin tatimor mbi kryerjen e obligimeve ndaj ATK-së.

Për me tepër, përfituesi i regjistruar si shoqëri aksionare ka pasur obligime tatimore dhe me rastin e pagesës, ATK ka aplikuar ndalesën në Thesar, dhe përfituesi si shoqëri aksionare ka përfituar shumën prej 27,717€.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesave të kontrolleve adekuate si dhe mungesa e kriterëve në rregulloren e brendshme për subvencionimin në rastet kur mjetet ndahen sipas vendimeve të Kuvendit Komunal.

Ndikimi

Rastet e lartcekura pa thirrje publike dhe pa kriteret të kërkuara sipas rregullës përkatëse, kanë ndikim në shfrytëzim jo racional të buxhetit, jo transparencë publike dhe përfitues jo të përgjegjshëm.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e subvencionimit të OJQ-ve do të respektohen kërkesat e dala nga rregullorja, ashtu që mbështetja financiare për OJQ-të, të bëhet me thirrje publike sipas kriterëve të përcaktuara me rregullore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore / përmbarimore

Gjetja

Neni 39 i LMFPP, përcakton që Zytari Kryesor Financiar (ZKF) i OB është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për OB-në të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim. Ndërsa sipas nenit 40 të LMFPP, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrin të prerë nga gjykata/përmbaruesi.

Si rezultat i vonesave në ekzekutimin e pagesave, nga kategoria e investimeve kapitale komuna ka paguar shumën prej 296,878€ si pasojë e vendimeve gjyqësore/përmbarimore duke përfshirë borxhin, interesat dhe shpenzimet përmbarimore në shumë prej 120,554€.

Kjo ka ndodhur për shkak kontrolleve jo adekuate në ekzekutimin e pagesave dhe menaxhim jo i mirë financiar lidhur me detyrimet e papaguara.

Ndikimi Pagesat përfshirë shpenzimet tjera përcjellëse të përmbarimit dhe interesit, ka shkaktuar kosto shtesë duke e dëmtuar buxhetin e komunës.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të forcoj kontrollet e brendshme duke e rrit mbikëqyrjen dhe verifikimin e rregullt të raporteve të detyrimeve të papaguara, njëherit duhet të siguroj që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mangësi për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale

Gjetja Ligji nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës neni 23 përcakton se pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës dhe kryetari i Komunës obligohet që ta njoftoj Kuvendin e Komunës pas përfundimit të çdo kontrate të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës, si dhe të jap propozimet për destinimin e saj në të ardhmen. Më tej, pas përfundimit të kontratës për shfrytëzimin afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës, mund të i vazhdohet afati në bazë të performancës.

Pesë kontrata të lidhura për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronave të komunës u kishte përfunduar afati i përcaktuar në kontratë (2009-2011). Për më tepër komuna nuk kishte zhvilluar procedura të cilat kërkojnë sipas rregullores për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale apo vazhdim të afatit të shfrytëzimit, por kishte lejuar operatorët ekonomik të shfrytëzojnë pronën pa marrëveshje kontraktuale. Prej tyre, në dy raste komuna i kishte faturuar OE ndërsa në tri raste nuk kishte faturuar OE për shfrytëzim të pronës komunale.

Mungesa e monitorimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim ishte shkak që këto prona të shfrytëzohen pa kontratë dhe të mos rrjedhin përfitime ekonomike nga përdorimi i tyre.

Ndikimi Shfrytëzimi i pronave komunale përtej periudhës së caktuar në kontratë si dhe mos faturimi i operatorëve ekonomik për shfrytëzim të pronës komunale krijon pa pajtueshmëri ligjore dhe rrjedhimisht më pak të hyra.

Rekomandimi A3 Kryetari të siguroj që të gjitha pronat pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës. Po ashtu, të siguroj që të zhvillohen procedurat përkatëse për dhënien e tyre në shfrytëzim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Tejkalim i kontratës publike kornizë

- Gjetja** Neni 56.15 Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh "Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit" artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Ne këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. Ne këto raste ne hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi".
- Komuna me datën 20.10.2020 kishte lidhur kontratë publike kornizë me çmim për njësi për "Rrënimin i objekteve, pastrimi i mbeturinave ilegale, pastrimi i shtratit të përrockave lumenjve dhe shërbimeve tjera publike në raste emergjente" në vlerë të parashikuar prej 96,505€. Ne kemi vërejtur se komuna kishte bërë tejkalim të kontratës për 271,258€.
- Kjo ka ndodhur për shkak të menaxhimit jo të mirë të kontratës si dhe certifikimit të pagesës jo në pajtim me kërkesat ligjore.
- Ndikimi** Tejkalimi i kontratave publike kornizë ndikon në rritjen e shpenzimeve shtesë të paarsyeshme dhe të paplanifikuara të parasë publike si dhe ndikon në rritjen e obligimeve komunale.
- Rekomandimi A4** Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që përmes menaxherit të kontratës do të bëhet mbikëqyrje e mirëfilltë e kontratave publike kornizë me çmim për njësi në mënyrë që të mos bëhet tejkalimi i tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A5 - Shkëputja e kontratës pas pranimit të situacionit të parë dhe lidhja e kontratës së re**

- Gjetja** Neni 40.1 e Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik shkruan se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP. Po ashtu neni 40.9 shkruan se AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve, sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në rast se shuma e korigjuar është më shumë se +/- 2%, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjalë duke përdorur formën standarde B42.
- Më datën 25.10.2022 në lidhje me projektin "Bashkëfinancim-Rehabilitimi i infrastrukturës fizike të komunitetit Rom, Ashkali, dhe Egjiptian në Plemetinë" është pranuar dhe paguar fatura në shumë prej 104,359€ në emër të situacionit të parë. Kontrata për këtë projekt ishte lidhur në shumë prej 249,168€ më datën 09.09.2022. Sipas dokumentacionit të rishikuar shihet se ky projekt është ndërprerë nga komuna si rezultat i gabimeve të gjetura nga bashkëfinancuesi MAPL në paramasën e operatorit ekonomik. Gabimet e konstatuara nga MAPL ishin rreth 9%, mbi atë të lejuar sipas rregullave të prokurimit deri 2%. Udhëheqësja e prokurimit më datën 14.10.2022 ka njoftuar OE për shkëputjen e kontratës.

Kjo ka ndodhur për shkak se komisioni i vlerësimit në kohën e ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderit nuk ka vërejtur gabimet në paramasën e operatorit. Si dhe pas përfundimit të procesit të vlerësimit, udhëheqësja e prokurimit nuk ka shqyrtuar propozimin për kontratë të rekomanduar nga komisioni vlerësues.

Ndikimi Mos identifikimi me kohë i gabimeve nga komisioni për vlerësimin e ofertës si dhe mos revidimi me kohë i projektit, ka ndikuar në kosto shtesë për komunën për këtë projekt.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të siguroj se komisioni për vlerësim bënë vlerësimin e duhur të ofertave duke mos shmangur gabimet aritmetikore në asnjë rast. Po ashtu duhet të kërkoj përgjegjësi nga kompania projektuese ngase kanë rrjedhur ndryshime në paramasën për të cilën veç se ka paguar komuna kompaninë projektuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Zotimi i mjeteve jo sipas rregullave financiare

Gjetja Rregulla financiare Nr.01/2013 neni 12 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhër blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimi të faturës të ekzekutohet pagesa.

Ne identifikua se:

- Në gjashtë raste (vlera e pagesave 111,753€) zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimi të mallit apo shërbimit/punëve dhe pranimi të faturës; dhe
- Në 28 raste (vlera e pagesave 791,658€), urdhër blerjet ishin bërë pas pranimi të mallit apo shërbimit dhe pranimi të faturës.

Kjo dukuri ka ndodhur për faktin që nuk janë zbatuar procedurat ligjore për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që komuna mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë, rrjedhimisht rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi dhe të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mos zhvillimi i procedurave të rekrutimit përmes SIMBNJ-së dhe mos publikimi i informative rreth procedurave të rekrutimit

Gjetja Ligji nr.06/L-114 për zyrtarët publik, neni 68 përcakton që hapja e procedurës së konkurrimit shpallet nga njësi e burimeve njerëzore në ueb faqen e konkurrimeve të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNj).

Njoftimet dhe procedurat e rekrutimit për personelin arsimor, nuk janë zhvilluar përmes SIMBNj-së. Në rekrutimet për mësimdhënës përveç konkursit publik, asnjë informatë tjetër rreth procesit të rekrutimit, si lista e ngushtë, njoftimet dhe rezultatet e testit me shkrim, intervistat dhe renditja përfundimtare e kandidatëve nuk janë publikuar në SIMBNj dhe as në ueb faqen e komunës.

Kjo ka ndodhur si rezultat i funksionimit të dobët të kontrolleve brendshme dhe mos zbatimit të kërkesave ligjore për procedurat e rekrutimit të personelit arsimor.

Ndikimi Mos publikimi i njoftimeve rreth procedurave të rekrutimit krijon jo transparencë rreth procesit dhe u pamundëson aplikantëve informimin rreth procesit të rekrutimit.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se procesi i rekrutimit të personelit zhvillohet sipas të ligjit për zyrtarët publik. Njoftimet dhe procedurat e rekrutimit duhet të zhvillohen përmes ueb faqes së konkurrimeve të SIMBNj-së dhe ueb faqes së komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për Paga e Mëditje ishte 4,480,473€ dhe deri në fund të vitit ishte realizuar 4,238,004 apo rreth 95%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 647 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 572 punëtor me orar të plotë dhe 67 punëtor me orar të shkurtuar.

Çështja A6 - Mungesa e autorizimeve paraprake për punë jashtë orarit

Gjetja Rregullorja nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera, neni 11, përcakton që nëpunësit civilë kanë të drejtë të kompensohen ose të marrin kohë të lirë për punën jashtë orarit, nëse mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë paraprakisht ka autorizuar dhe vërtetuar punën jashtë orarit. Kërkesa për kompensim për punë jashtë orarit dërgohet për aprovim tek udhëheqësi më i lartë administrativ brenda pesë (5) ditëve të punës, pas datës në të cilën janë plotësuar orët e punës jashtë orarit.

Gjatë vitit 2022, 265 punonjës ishin kompensuar për punë jashtë orarit në vlerë 39,565€. Këta punonjës nuk ishin autorizuar paraprakisht nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Për më tepër kërkesa për kompensim për punë jashtë orarit ishte bërë deri në tre muaj vonesë.

Shkak i kësaj është mungesa e kontrolleve të brendshme dhe se ishte konsideruar si e mjaftueshme aprovimi i punëve shtesë në fund.

Ndikimi Mungesa e autorizimeve paraprake nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe kërkesat për kompensim për punë jashtë orarit me vonesë rrit rrezikun që punonjësit të mos realizojnë punët brenda orarit të paraparë në kontratë dhe krijimin e shpenzimeve pa bazë ligjore.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë se punët shtesë realizohen vetëm nëse paraprakisht janë autorizuar orët e punëve shtesë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, dhe se kërkesa për kompensim bëhet brenda afatit të paraparë kohor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti për mallra dhe shërbime përfshirë komunalitë ishte 1,866,734€ deri sa ishin shpenzuar 1,689,399€ apo rreth 91%.

Çështja A7 - Realizimi i aktiviteteve jashtë planit të prokurimit dhe mos njoftim i AQP-së

Gjetja Bazuar në Nenin 8 të Ligjit për Prokurimin Publik (me ndryshime dhe plotësime) AK duhet të bëjë planin e prokurimit, në të cilin identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që AK parasheh ti prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë. Ndërsa sipas nenit 9, pika 6, e ligjit të njëjtë precizohet që nëse aktiviteti i prokurimit nuk është përfshirë në planifikimin final të prokurimit, duhet të njoftohet Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) të paktën 5 ditë para autorizimit të inicimit të aktivitetit të prokurimit.

Kontrata që ka të bëjë me organizimin e festivalit Zjarr dhe Akull në vlerë 13,600€, nuk ishte përfshirë në planin final të prokurimit dhe nuk ishte njoftuar AQP-ja siç kërkohet me LPP-në.

Kjo ka ndodhur për shkak të mospërfilljes së rregullave dhe kërkesave ligjore nga zyrtaret përgjegjës të prokurimit.

Ndikimi Ndikimi Planifikimi jo i plotë i aktiviteteve prokurimit, dhe realizimi i prokurimeve jashtë planit e vështirësojnë realizimin e planit të prokurimit dhe monitorimin e performancës si dhe krijojnë vështirësi financiare për komunën.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë se do të merr masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP sipas kërkesave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Përdorim jo i duhur i procedurës së prokurimit

Gjetja Sipas nenit 35 të LPP, autoriteti kontraktues përjashtimisht mund ta përdor procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë për dhënien e çdo lloji të kontratës, nëse rrethanat e arsyetojnë përdorimin e kësaj procedure.

Neni 52.3 Autoritet kontraktuese duhet të sigurohen se ekzistojnë rrethana precize që i arsyetojnë negociatat para se të vendoset për përdorimin e kësaj procedure. Rasti kryesor ku kjo procedurë mund të përdoret është:

- Kur për arsye teknike ose artistike ekziston vetëm një Operator i mundshëm ekonomik;
- Për shkak të ekzistimit të të drejtave ekskluzive të autorit ose industriale ekziston vetëm një Operator i mundshëm ekonomik; dhe
- Në rastet e urgjencës ekstreme.

Zyra e prokurimit ka lidhur kontratë për Përfaqësimin ligjor të Komunës së

Obiliqit në gjykata, më datë 13.04.2022 në vlerë 98,000€, duke përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Në këtë rast duhej përdorur procedurë e hapur, për shkak se asnjë nga kriteret e përmendura nga rregulla dhe udhëzuesi operativ nuk janë plotësuar.

Kjo ka ndodhur nga pakujdesia e zyrës së prokurimit për t'i respektuar kërkesat e parapara ligjore.

Ndikimi

Aplikimi i procedurës jo adekuate mund të ndikoj në dëmtimin e konkurrencës, transparencës lidhur me zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Rekomandimi A8

Kryetari duhet të siguroj që zyra e prokurimit aplikon procedurat e duhura të prokurimit ashtu siç parashihet me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,126,167€, prej tyre ishin shpenzuar 4,737,999€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, objektet arsimore, mirëmbajtje investive, pajisje tjera etj.

Çështja A9 - Dobësitë lidhur me kontratën përmes çmimit të poentuar

Gjetja Ligji Nr. 04/L-042 neni 18 parasheh se vlera e parashikuar e një kontrate të propozuar të punëve është e barabartë me çmimin e parashikuar që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha punët, shërbimet, produktet si dhe lëndët e tjera që mbulohen nga ajo.

Më datën 24.05.2022 duke aplikuar procedurën e poentimit të çmimit, Komuna e Obiliqit ka lidhur kontratë me OE për projektin " Shtruarja e rrugëve me zhavorr" sipas çmimit të poentuar prej 90.49€ për 3 vite. Vlera e parashikuar e tenderit për këtë projekt ishte 90,000€, e cila nuk është paraqitur në kontratë. Në dosje të tenderit nuk është specifikuar se në cilat rrugë do të shtrohet zhavorri. Për më tepër, te pagesa e situacionit të parë në shumë prej 23,673€, është vërejtur se punët janë llogaritur dhe paguar për 26 rruge të ndryshme.

Sipas zyrës së prokurimit, procedura e poentimit të çmimit është zhvilluar pasi njësia kërkuese nuk ka qenë në gjendje të matë sasinë e porosisë me zhavor.

Ndikimi Mos specifikimi i lokacionit dhe detajet tjera me kontratë, nuk jep siguri mbi ekzekutimin e projektit se në cilat rrugë duhet të zhvillohen punimet sa duhet të jetë vlera totale për realizimin e projektit, si dhe paramasa të paqarta për monitorimin dhe raportimin e mbarëvajtjes së projektit.

Rekomandimi A9 Kryetari duhet të siguroj se njësia kërkuese do të përgatisë paramasën dhe parallogarinë sipas sasive indikative, me qëllim të shmangies së keqpërdorimit të mundshëm nga zhvillimi i procedurave të prokurimit sipas poentimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Klasifikimi jo i duhur i shpenzimeve kapitale

Gjetja Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Si rezultat i planifikimit jo adekuat të buxhetit nga kategoria e investimeve kapitale, komuna ka paguar 12,312€ në emër të projektit " Mirëmbajtja dhe rregullimi i varrezave". Rrjedhimisht se llogaria e investimeve kapitale është mbivlerësuar për këtë vlerë.

Kjo ka ndodhur si pasojë se projekti ishte planifikuar dhe buxhetuar gabimisht.

Ndikimi Pagesa e realizuar nga kategoria jo-adekuate, rezultonë me prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në Pasqyrat Financiare. Raportimi jo i drejtë i të dhënave për klasifikimin e shpenzimeve kapitale mund të ndikoj edhe në vendime të gabuara nga menaxhmenti i komunës.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se buxheti vjetor planifikohet në kategoritë përkatëse ekonomike, me tutje të sigurohet se të gjitha shpenzimet janë klasifikuar në mënyrë të saktë dhe të drejtë në raportimet financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera neto e pasurive kapitale e paraqitur në PFV e vitit 2022 është 57,563,689€, pasurive jokapitale është 481,632€ si dhe e stoqeve 476,508€.

Çështja C1 - Dobësitë në regjistrat kontabël të pasurive

Gjetja

Me Rregulloren MF-Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, kërkohet që pasuria kapitale të regjistrohet në SIMFK, pasuria jokapitale dhe stoqet të regjistrohen në sistemin e-pasuria, dhe se të gjitha pasuritë i nënshtrohen normave të zhvlerësimit. Gjithashtu kërkohet që në fund të vitit të bëhet inventarizimi i pasurisë.

Në sistemin e-pasuria nuk është llogaritur në tërësi zhvlerësimi i pasurisë jokapitale. Bazuar në të dhënat e prezantuara në vitin 2022 në aneksin e pasqyrave financiare neni 19.3.2 shihet se komuna ka prezantuar shumën 481,632€ si bruto ashtu edhe neto për pasurit jo kapitale nën 1,000€ si rezultat i mos llogaritjes së zhvlerësimit të tyre. Po ashtu, ne kemi vërejtur se tre kamion të blerë në fund të vitit me bashkëfinancim në shumë totale 203,850€, nuk ishin regjistruar në SIMKF, ndonëse ishin pranuar nga komisioni për pranim teknik.

Sipas zyrtares së pasurisë, mos llogaritja e zhvlerësimit për pasuritë nën 1,000€ ka ndodhur për shkak të mosfunksionimit të vetë sistemit ndërsa, mos regjistrimi i kamionetave në SIMKF ka ndodhur për shkak të mos pranimit të dokumentacionit nga MAPL lidhur me regjistrimin e tyre në pronësi të komunës.

Ndikimi

Mos regjistrimi i pasurive kapitale (kamionetat) në regjistrin kontabël dhe mos llogaritja e zhvlerësimit tek pasuritë jo kapitale, ndikojnë në prezantimin jo të drejtë dhe të saktë në PFV, duke nën vlerësuar vlerën e tyre.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë kapitale të jenë të regjistruara në regjistrin kontabël, po ashtu të sigurojë se pasurive jo kapitale iu llogaritet zhvlerësimi sipas normave përkatëse, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2022 ka shpalosur Llogari të Aarkëtueshme në vlerë prej 1,379,622€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë dhe në tokë, taksa në biznes, shfrytëzimi i pronës publike, dhe qiraja nga objektet publike etj.

Çështja B4 - Rritja e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 26 të ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L- 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kapitulli për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 përcakton se nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendrike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhje e llogarive të arkëtueshme (LIA) pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Gjatë vitit 2022 edhe pse LIA-të ishin rritur për 33,386€ në krahasim me vitin paraprak, komuna nuk kishte marrë ndonjë veprim konkret për inkasimin e tyre. Pjesëmarrjen më të madhe të të arkëtueshmeve e ka tatimi në pronë me 981,603€, pastaj tarifa vjetore në biznes 90,870€ dhe të tjerat 307,149€.

Dobësitë e identifikuar ishin për shkak të kontrolleve të brendshme jo adekuate dhe mungesës së veprimeve përkatëse për inkasimin e tyre.

Ndikimi Mos arkëtimi me kohë i LIA-ve reflekton në shkallë më të ulët të buxhetit nga të hyrat vetanake. Njëkohësisht kjo mund të ndikoj edhe në arritjen e objektivave të komunës, duke pamundësuar investime në projekte që financohen nga këto fonde.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga obliguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, përfshirë edhe veprimet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.6 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me vetëm një auditor të brendshëm. NjAB ka përgatitur planin vjetor dhe planin strategjik. Komiteti i Auditimit gjatë vitit ka mbajtur 5 takime pune.

Çështja B5 - Mos realizimi i planit vjetor të auditimit të brendshëm dhe vonesa në raportim në Njësinë Qendrore Harmonizuese (NjQH)

Gjetja Plani vjetor i auditimit pritet të realizohet brenda vitit në përputhje me afatet e përcaktuara. Rregullorja QRK-Nr.01/2019, neni 11, pika 4, përcakton që drejtori i NJAB përgatit dhe dorëzon raportin e gjashtëmujorit të parë dhe të dytë, si dhe raportin vjetor tek udhëheqësi i organizatës, komiteti i auditimit dhe NjQH më së largu deri me 15 korrik të vitit, gjegjësisht deri më 15 janar të vitit vijues.

Auditori i Brendshëm (AB) gjatë vitit 2022 kishte realizuar vetëm tre auditime nga katër të planifikuara. Aktivitetet e përfshira në njërin nga auditimet e realizuara i takojnë periudhës 01.04.2021-31.03.2022. Po ashtu, NjAB raportin për gjashtëmujorin e parë e kishte dorëzuar me vonesë.

Kjo ka ndodhur për shkak të kapaciteteve të kufizuara të stafit në NjAB, ndonëse Komuna ka bërë përpjekje për rekrutim të stafit për këtë njësi. Në anën tjetër, kjo është reflektuar edhe për shkak të mungesës së mbikëqyrjes vlerësimit të aktivitetit të auditimit në përmbushjen e planit nga Komiteti i Auditimit, cili gjatë vitit kishte mbajtur 3 takime (një në muajin mars dhe dy në dhjetor).

Ndikimi Në mungesë realizimit të auditimeve të brendshme dhe për periudhën përkatëse, menaxhmentit mund të mos i është ofruar informacion i duhur për funksionimin dhe efikasitetin e kontrolleve të brendshme në organizatë.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të vazhdojë përpjekjet për plotësimin e NjAB-së me staf të nevojshëm, me qëllim të shtimit të kapaciteteve njerëzore, në mënyrë që të arrihet realizimi i planit vjetor të auditimit brenda afateve të përcaktuara, dhe se kërkesat ligjore për raportim nga NjAB realizohen brenda afateve të përcaktuara me rregulloren përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	11,822,169	12,580,768	11,755,534	10,610,302	10,711,191
Grante Qeveritare - Buxheti	10,913,439	10,919,448	10,319,764	9,300,101	9,330,099
Financimi përmes huamarrjes	0	76,464	76,464	20,389	59,535
Të bartura nga viti i kaluar	0	368,930	366,512	412,225	631,929
Të hyrat vetanake	908,730	1,122,713	967,591	877,427	680,088
Donacionet vendore	0	25,933	25,203	160	0
Donacionet e jashtëme	0	67,280	0	0	9,540

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 758,599€, kjo rritje është rezultat i kursimeve nga granti qeveritar në bazë të vendimit të qeverisë për 6,009€, bartjes së të hyrave nga viti paraprak 368,930€, rritjes së të hyrave vetanake për vitin 2022 prej 213,983€, fondeve nga huamarrja 76,464€ dhe përfitimi i fondeve nga donatorët e brendshëm 25,933€ dhe të jashtëm për 67,280€.

Në vitin 2022 Komuna ka shpenzuar 93% të buxhetit final ose 11,755,534€, me realizim më të mirë se vitin e kaluar (2021 - 91%). Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	11,822,169	12,580,768	11,755,534	10,610,302	10,711,191
Pagat dhe mëditjet	4,350,000	4,480,473	4,238,004	4,240,542	4,229,433
Mallrat dhe shërbimet	1,288,679	1,550,059	1,430,204	1,129,767	891,321
Komunalitë	316,675	316,675	259,195	255,179	209,633
Subvencionet dhe transferet	850,000	1,107,395	1,090,132	931,713	1,005,138
Investimet Kapitale	5,016,815	5,126,167	4,737,999	4,053,101	4,375,666

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final me buxhetin fillestar të kategoria paga dhe mëditje ishte rritur për 130,473€ si rezultat i pagesave nga vendimet gjyqësore dhe shpenzimeve për Covid19;
- Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 261,380€, apo 92% e buxhetit ishte shpenzuar ndërsa komunalit nuk kishte ndonjë ndryshim të buxhetit fillestar me atë final;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur 257,395€, përderisa realizimi ishte në masën 98% e buxhetit final; dhe
- Buxheti final në kategorinë e investimeve kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 109,352€, apo 92% e buxhetit ishte shpenzuar. Dinamika e realizimit për 27 projekte nuk është në harmoni me planifikimet, sepse 3,486,074€ apo 74% e shpenzimeve nga kjo kategori janë realizuar në tremujorin e fund vitit. Rritjes së investimeve kapitale i ka kontribuar dhe pagesa prej 1,184,968€ apo 10% e vlerës së kontratës në emër të projektit " Ko gjenerimi".

Si rezultat i situatës pandemie me COVID-19, Komuna e Obiliqit kishte shpenzuar 76,464€, prej të cilave janë paguar për paga dhe mëditje.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e planifikuara për vitin 2022 ishin 908,730€, ndërsa janë realizuar 1,129,173€, duke tejkaluar planin për 24%. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj.

Gjithashtu, në vitin 2022 Komuna e Obiliqit ka përfituar të hyra nga gjobat në trafik në vlerë 189,134€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikon dhe i realizon Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa komunës i alokohen për shpenzime.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	908,730	908,730	1,129,173	1,031,656	776,820
Të hyrat tatimore	446,655	446,655	423,468	373,705	362,267
Të hyrat jo tatimore	462,075	462,075	705,705	657,950	414,553

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2021 për Komunën e Obiliqit ka rezultuar me 12 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit për vitin 2021 si dhe plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është diskutuar në Kuvendin Komunal të Obiliqit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar dhe pesë (5) nuk janë adresuar ende, dhe një pjesërisht i zbatuar. siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4: Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që përbërja e komisionit vlerësues të jetë në pajtim me kriteret e përcaktuara me Rregulloren MF-Nr.04/2017.	Janë ndërmarre veprime të nevojshme.	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se obligimet financiare ndaj kontraktuesve paguhen brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditëve nga pranimi i faturës.	Janë ndërmarre veprimet të nevojshme.	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se procesi i rekrutimit të personelit zhvillohet sipas të ligjit për zyrtarët publik. Njoftimet dhe procedurat e rekrutimit duhet të zhvillohen përmes ueb faqes së konkurrimeve të SIMBNj-së dhe ueb faqes së komunës.	Nuk janë ndërmarre veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin

4.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë se PVF për vitin 2022 përgatiten sipas standardeve dhe kërkesave ligjore për raportim financiar. Informatat buxhetore të shpalosen në fondet përkatëse buxhetore. Para nënshkrimit të Deklaratës për PVF, Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të sigurojnë se informatat financiare janë prezantuar drejtë dhe saktë.	Janë ndërmarre veprimet të nevojshme.	I zbatuar
5.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se rekrutimi i punonjësve realizohet vetëm në bazë të konkursit publik të hapur dhe konkurrues. Kontratat e punës për kohë të caktuar të ndërpriten me skadimin e afatit apo përbushjes së kushteve kontraktuale.	Janë ndërmarre veprimet të nevojshme.	I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që nënshkrimit të kontratës ti paraprijë zotimi i mjeteve financiare në SIMFK, dhe të pasohet më tej me përgatitjen e urdhërblërjes për furnizimet apo shërbimet e kontraktuara. Ofertat nuk duhet të tejkalojnë vlerën e parashikuar të kontratës, dhe se vlera e sigurisë së ekzekutimit të kontratës bëhet siç përcaktohet me njoftimin për kontratë.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbikëqyrin dhe sigurojnë se kontratat publike po realizohen sipas kushteve kontraktuale. Gjithashtu të sigurohet se specifikimet teknike të kontratës nuk përcaktojnë llojin apo markën tregtare të paisjeve.	Janë ndërmarrë disa veprime.	I zbatuar
8.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë që te kontratave publike të përcaktuara në bazë të përqindjes apo peshimit të pozicioneve të kontraktuara, i njëjti raport i peshimit të ruhet edhe gjatë realizimit përkatësisht pagesave.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
9.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet klasifikohen dhe paguhen nga buxheti i kategorive përkatëse ekonomike.	Nuk janë ndërmarre veprimet të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se kërkesat për regjistrim, zhvlerësim dhe inventarizim të pasurisë zbatohen në pajtim me kërkesat e Rregullores MF-Nr. 02/2013.	Janë ndërmarre veprimet të pjesërishme për zbatimin e këtij rekomandimi.	Pjesërisht i zbatuar
11.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga obliguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, përfshirë edhe veprimet ligjore.	Nuk janë ndërmarre veprimet të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin

12.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se NjAB realizon planin vjetor të auditimit brenda afateve të përcaktuara, dhe se kërkesat ligjore për raportim nga NjAB realizohen brenda afateve të përcaktuara me rregulloren përkatëse.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi
-----	----------------------	--	-----------------------------	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Florim Maliqi, Udhëheqës i ekipit




Ganimete Dalloshi, Anëtare e ekipit



Arbresha Grainca, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Komuna e Obiliqit - Opština Obilic - Municipality Obilic

Zyra e kryetarit

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Obiliq, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem/ nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Xhafer Gashi
(Kryetar i Komunës)

Data: 16.06.2023, Obiliq



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.